

Nr. _____ prot.,

Data ____ . ____ .2024

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Sherbim i ruajtjes dhe sigurise fizike me roje fizike/monitorim me sistem sigurie kamera /alarmi dhe grup te gatshem per te gjitha objektet nen administrimin e Shoqerise Rajonale Ujesjelles Kanalizime Pogradec– Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 36 muaj

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

79713000-5 - Shërbime roje/shërbime me roje

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi Limit i Marrëveshjes Kuadër: **21,597,814.08**(njetet e nje milion e peseqind e nentedhjet e shtate mije e teteqind e katermbedhjet pike zero tete)

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Ujesjelles Kanalizime sha Rajoni Pogradec ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; **431 956,28** (katerqind e tridhjet e nje mije e nenteqind e pesedhjet e gjashte presje njezet e tete) **leke**.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Operatori ofertues duhet të paraqesë Licensë QKL për ushtrim aktiviteti “Sigurimi Fizik i Personave dhe Objekteve Shtetërore e Private“, me roje të kategorisë 1.3.A dhe Çertifikatë profesionale të titullarit të subjektit shoqëruar me cv e tij, konform Ligjit nr. 75 datë 10.07.2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike“.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe Ligjit nr. 75 datë 10.07.2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike“.

2.1.2 Çertifikatë e Drejtuesit Teknik shoqëruar me cv e tij të vlefshme për ushtrimin e veprimtarisë së ruajtjes dhe të sigurisë fizike për nënkategorinë 1.3.A.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshur me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

2.1.3. Çertifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave për të paktën shtatë punonjës shërbimi, të lëshuara nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Korçë dhe dy punonjës shërbimi, të lëshuara nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Elbasan.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë:

Ne baze të vendorjeve të kerkuara qe jane:

1. Nje vendroje me sherbim 24 ore ne **Depo Uji Verdove Pogradec**,
2. Nje vendroje me sherbim 8 ore ne dite (40 ore ne jave) ne **Zyra e Shitjes ne Rruga “Rinia”**

3. Nje vendroje me sherbim 8 ore ne dite (40 ore ne jave) ne Qendra e sherbimit Konsumator Prrenjas.

Pogradec

- 1 vendroje me sherbim 24 ore ne dite 7 dite ne jave = **4.98 roje**
- 1 vendroje me sherbim 8 ore ne dite 5 dite ne jave = **1.18 roje**

Totali: 6.16 punonjes (7 certifikata per punonjes sherbimi të lëshuara nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Korçë)

Prrenjas

- 1 vendroje me sherbim 8 ore ne dite 5 dite ne jave = **1.18 roje**
- **Totali: 1.18 punonjes**

Totali:1.18 punonjes (2 certifikata per punonjes sherbimi të lëshuara nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Elbasan)

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet te paraqese Vertetimin nga Administrata Tatimore mbi xhiron vjetore, të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2021, 2022, 2023), me vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit Marreveshjes kuader të që prokurohet. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", e ndryshuar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:*

Pika 1 dhe pika 2/b e nenit 43 të VKM nr. 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur, perkatesisht; Pika 2/b: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; Duke qene se kjo procedure prokurimi eshte bazuar ne vleren e fondit limit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, AK duke u bazuar ne eksperiencen e suksesshme te procedurave te zhvilluara me pare gjykon se është e pershtatshme vendosja e kriterit te marzheve maksimale të përcaktuara në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për

të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, **për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare**; si dhe nenit 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin Mbi të Ardhurat" i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave;

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqese bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, të certifikuara nga autoritetet përkatese (Dega e Tatim Taksave) ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", e ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në ligjin nr.25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"

2.2.3 Vërtetim lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e taksave për vitin 2021-2022-2023, për adresat ku ushtron aktivitetet operatori ekonomik, sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKB.

Argumentimi: Ne lidhje me kërkesën për pagesën e taksave vendore referojmë se në bazë të pikave 1 dhe 3, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", në Neni 5, Rregulla të përbashkëta për taksat vendore, dhe në Kreu II, Taksat vendore, Neni 9, Llojet e taksave vendore, të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 Për Sistemin e Taksave Vendore, (i Ndryshuar). Komisioni kerkoi edhe pagesat e taksave vendore bazuar në Ligjin Nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" (te ndryshuar), neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të percaktuara nga cdo njesi e qeverisjes vendore si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, ku përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrorjnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

Komisioni përcaktoi kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart, duke qënë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.2.3 Operatori ofertues duhet të paraqesë Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për tre muajt e fundit (Janar-Shkurt-Mars 2024), shoqëruar me **listë pagesat e sigurimeve shoqërore** (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë. Operatori

ekonomik duhet të ketë minimalisht njëmbëdhjetë punonjes të siguruar në muaj, si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin. Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkoheq sgarime nga autoriteti kontraktor

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Ky kriter shërben për të garantuar dhe provuar që OE ka kapacitetet teknike profesionale për të përmbushur qëllimin e kontratës së shërbimit.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë:

Ne baze te vendorojeve te kerkuara qe jane:

1. Nje vendroje me sherbim 24 ore ne **Depo Uji Verdove Pogradec**,
2. Nje vendroje me sherbim 8 ore ne dite (40 ore ne jave) ne **Zyra e Shitjes ne Rruga “Rinia”**
3. Nje vendroje me sherbim 8 ore ne dite (40 ore ne jave) ne **Qendra e shërbimit Konsumator Prrenjas.**

Pogradec

- 1 vendroje me sherbim 24 ore ne dite 7 dite ne jave = **4.98 roje**
- 1 vendroje me sherbim 8 ore ne dite 5 dite ne jave = **1.18 roje**

Totali: 6.16 punonjes

Prrenjas

- 1 vendroje me sherbim 8 ore ne dite 5 dite ne jave = **1.18 roje**
- **Totali: 1.18 punonjes**

Totali:1.18 punonjes

Nje drejtues teknik

Nje administrator

Nje punonjes të trajnuar për sistemet e alarmit,

Nje punonjes te trajnuar per sistemet e kamerave

Totali I punonjesve 12 punonjes

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit të limit të Marrëveshjes kuadër.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a- Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku shënohen datat, shumat, zërat dhe sasitë e shërbimeve të realizuara ose fatura tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat, zërat dhe sasitë e shërbimeve të realizuara.

ose

b - Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e shërbimeve të realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ofertues duhet të paraqesë Autorizim Individual në emër të shoqërisë për përdorimin e frekuencave për radiokomunikim dhe alarm të lëshuar nga AKEP në zbatim të ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, me zonë mbulimi zona apo zonat ku kërkohet shërbimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a.) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, si dhe të ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente. Kërkesa për paraqitjen e Autorizimit të lëshuar nga AKEP, është e domosdoshme pasi tregon që operatorët ekonomikë kanë zonë mbulimi frekuencash radiokomunikim, radioalarm mbi të gjitha objektet që do të ruhen me punonjësit e shërbimit të SHPSF.

2.3.3 Vërtetim Performance nga Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut Korçë dhe Elbasan lëshuar në vitin 2024.

Ky vertetim duhet të përmbaje informacionin dhe opinionin që disponon Drejtoria e Policisë së Qarkut sa më poshtë për :

- a) Qendra e kontrollit të shërbimit.
- b) Të ketë numrin e punonjësve të shërbimit të licensuar nga DPQ-të përkatëse për kategorinë 1.3.A, në jo më pak se numri i punonjësve të kërkuar (7 punonjes ne Korçë dhe 2 punonjes ne Elbasan),
- c) Operatori Ekonomik të mos ketë shkelje të konstatuara dhe mase administrative të marre nga Drejtoria Vendore e Policisë për Subjektin, Titullar Subjekti dhe Drejtues Teknik për periudhën Janar 2023 e në vazhdim.
- d) Vertetimi të përmbaje vlerësim përmbledhës për performancën e Operatorit Ekonomik.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, si dhe të ligjit ligjit nr.75/2014, datë 10.07.2014, ‘Per shërbimin privat të sigurisë fizike’, të ndryshuar si dhe akteve nenligjore të dala në zbatim të tij.

2.3.4 Shoqëria duhet të disponojë pajisje speciale. Kjo do të vërtetohet duke u paraqitur dokumentacioni i blerjes së pajisjeve (fatura tatimore për pranga, shkop gome, radio, elektrik dore, spray neuroparalizues, dedektor, alarme, kamera ose deklaratën doganore të mallit. Autoriteti rezervon të drejtën e verifikimit të pajisjeve të salles *Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.3.5 Për funksionimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të kamerave dhe sistemeve të alarmit operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 1 (një) punonjës specialist i kualifikuar, i diplomuar në profil informatik i cili duhet të figurojë në listpagesa për periudhën 3 (tre) muajt e fundit. Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht 1 (një) punonjës të trajnuar për sistemet e alarmit, dhe një punonjës të trajnuar për sistemet e kamerave për të cilët operatori ekonomik duhet të paraqesi certifikate trajnimit nga kompani të licencuara dhe të figurojnë në listpagesa për periudhën 3 (tre) muajt e fundit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ”Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim” nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik.

2.3.6 Ofertuesi duhet të disponojë 1 automjet per secilin Qark ku do te kryhet sherbimi për ndërhyrje në raste emergjente, në pronësi të shoqërisë apo të marrë me qera. Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

Leje e Qarkullimit dhe taksat e mjetit (të vlefshme) në pronësi të shoqërisë. Në rastin kur mjeti është marre me qera,

Leja e Qarkullimit duhet të shoqërohet edhe me Kontratën noteriale të marrjes me qera, ku të jetë përcaktuar afati dhe qëllimi i marrjes me qera.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë mjetet e nevojshme në dispozicion për realizimin në kohë dhe me sukses të kontratës.

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin analizen e kostos për ofertën e paraqitur. **(Shih Shtojca 1,2 - Sqarime)**

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 3 të LPP, si dhe nenet 41 dhe 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

Ky kriter vendoset në zbatim të Rekomandimit të Përbashkët të APP dhe KPP nr. 15166 prot., datë 20.12.2017 “Rekomandim mbi mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit për shërbimin privat të ruajtjes fizike”, i ndryshuar.

Bazuar në nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, dhe në formularin e kriterëve të përzgjedhjes/ kualifikimit Shtojca 7 e DT, fituesi duhet të dorëzojë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dokumentat e specifikuar në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “j” si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.
